



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1016/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomë e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj – Sheremeti dhe Dren Rogova, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - konfliktin administrativ sipas propozuesit – paditësit “KRU Prishtina” sh.a, me seli ne Prishtinë, kundër kundërshtares se propozimit - të paditurës Ministria e Financave dhe Transfereve, Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, me bazë juridike për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, nr.539 te datës 05.12.2023 duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit - propozuesit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Pare - Departamenti për çështje administrative K.A.nr.90/24, të datës 29.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit – paditësit “KRU Prishtina” sh.a, me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Pare - Departamenti për Çështje administrative K.A.nr.90/24, të datës 29.02.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Administrative, është refuzuar propozimi i paditësit – propozuesit “KRU Prishtina” sh.a, me seli ne Prishtinë, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.539 te datës 05.12.2023 te Ministrisë se Financave dhe Transfereve, Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, më të cilin aktvendim është vërtetuar vendimi i shkalles se parë Nr.01/56-252/2023/GJ i dt.10.10.2023.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Administrative ka ushtruar ankesë i autorizuar paditëses – propozueses, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dyte aktvendimin e kontestuar ta ndryshon dhe tëaprovojë kërkesën e paditëses – propozueses për lejimin e masës së propozuar apo ta

prish aktvendimin e goditur dhe lëndën ta kthejë gjykatës së shkallës së parë përvendosje.

Kolegji i Gjykatës Komerciale e Kosoves -Dhoma e shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Duke shqyrtaur shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së propozuesit – paditëses, kolegji i kësaj gjykate, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrimit të propozimit të paditësit për shtyrje e ekzekutimit të vendim nr.539 te datës 05.12.2023 te Ministrisë se Financave dhe Transfereve, Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, më të cilin aktvendim është vërtetuar vendimi i shkalles se parë Nr.01/56-252/2023/GJ i dt.10.10.2023, ka gjetur se propozimi i tillë është i pabazuar, ngase paditësi e nuk e ka bërë të besueshme si dhe nuk ka prezantuar prova qe te vërtetoj faktin se ekzekutimi i vendimit do te i sillte dëme paditësit - propozuesit, i cili vështirë se do te riparohej, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA).

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një konkludim të tillë të gjykatës së shkallës së parë ngase edhe sipas vlerësimit të kolegit të kësaj gjykate, në rastin konkret rezulton se nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par. 6 lidhur me par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se: “ me kërkese e paditësit, organi akt i te cilit ekzekutohet gjegjësisht organi qe është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri ne vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do ti sillte dem paditësit, i cili vështir do te riparohej, kurse shtyrja nuk është ne kundërshtim me interesin publik, apo qe shtyrja do ti sjellë ndonjë dem te madhe palës kundërshtare përkatesisht personit te interesuar”.

Gjykata e shkalles se pare, me rastin e vendosjes sipas propozimit te paditësit - propozuesit, ka gjetur se pala paditëse – propozuese nuk e ka bere te besueshëm faktin se shtyrja e ekzekutimit te vendimit deri ne vendosjen e çështjes ne mënyre meritore, nuk është ne kundërshtim me interesin publik e as qe do t i sillte ndonjë dëme palës kundërshtare apo personave te interesuar, me sakte një vendim i tillë do ti shmange pasojat e mundshme qe do ti shkaktohesin ne te ardhmen nëse vendimi i kundërshtar i te paditurës ne fund te procesit gjyqësor eventualisht rezulton se është marre ne kundërshtim me Ligjin.

Gjykata e shkalles se pare ne vendimin e saj, ka konstatuar se paditësja ne pretendimet e saja nuk ka arsyetuar se te njëjtat janë te bazuara ne Ligj dhe se ne rastin konkret janë përbushur kushtet Ligjore qe te aprovohet propozimi për shtyrje te ekzekutimit te vendimit deri sa gjykata te vendos përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e vendimit te kontestuar përkitazi me padinë e paditësit e ne kuptim te nenit 22 te LKA-se.

Me që nga shkresat të cilat gjinden në lëndë rezulton se me vendimin nr.539 te datës 05.12.2023 te Ministrisë se Financave dhe Transfereve, Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, më të cilin aktvendim është vërtetuar vendimi i shkalles se parë Nr.01/56-252/2023/GJ i dt.10.10.2023 është detyruar paditësja qe te paguaje gjobën ne lartësi prej 1,000.00 euro, pasi qe është gjetur përgjegjëse për cenimin e dispozitave te Ligjit te Punës Nr.03/L-212, neni 8 par.2 dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr.07/2017, neni 11 par.8, për shkak te mos mbajtjes se shënimeve gjate procesit te intervistimit.

Po ashtu, Gjykata e Shkallës së dytë konstaton se pala propozuese pretendimet e saja nuk i ka mbështetur në prova, duke mos i prezantuar gjykatës asnjë provë të vetme si dhe duke mos propozuar marrjen e provave me të cilat do të vërtetohet pretendimi i propozuesit për dëm konkret, i cili vështir do të riparohej, pra pala propozuese nuk e ka bërë të besueshme kërkeshën e tij se ekzekutimi i vendimit do ti sillte dëm, po ashtu nuk e ka ber të besueshëm as pretendimin se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozueses – paditëses, në ankesë të cekura më lartë ndaj aktvendimit të shkallës së parë, kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se gjykata e shkalles se pare, në mënyrë të drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale dhe nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit te propozimit për caktimin e masës se përkohshme dhe shtyrjes se ekzekutimit te vendimit dhe se pretendimet ankimore janë të pa ndikim për vendosje në mënyrë tjetër, andaj ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1016/2024, me datë 28.05.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Faton Bajrami, d.v